

**MARRËVESHJE
NDËRMJET
REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE
MBRETËRISË SË HOLANDËS
PËR ELEMENIMIN E TATIMIT TË DYFISHTË SA I PËRKET
TATIMIT NË TË ARDHURA
DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL DHE
SHMANGIES**

REPUBLIKA E KOSOVËS

në një rën anë

DHE

MBNRETËRIA E HOLANDËS

në anën tjetër,

DUKE DËSHIRUAR që të zhvillojnë më tutje marrëdhëniet e tyre ekonomike dhe për ta rritur bashkëpunimin e tyre në çështjet tatimore,

DUKE SYNUAR arritjen e një Marrëveshjeje për eliminimin e tatimit të dyfishtë sa i përket tatimeve në të ardhura pa krijuar mundësi për mos-tatim apo tatim të zvogëluar përmes evazionit fiskal apo shmangies (përfshirë përmes traktateve-marrëveshjeve të blerjes që synojnë marrjen e lehtësimeve të parashikuara në këtë Marrëveshje për përfitimi indirekt të banorëve të juridiksioneve të treta),

JANË PAJTUAR si më poshtë:

KAPITULLI I FUSHËVEPRIMI I MARRËVESHJES

NENI 1

PERSONAT E MBULUAR

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për personat që janë rezident të njërit Shtet apo të të dy Shteteve Kontraktuese.
2. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, të ardhurat që burojnë nga ose përmes ndonjë subjekti apo aranzhimi që trajtohet plotësisht apo pjesërisht në mënyrë fiskale e transparente sipas ligjit mbi tatimin të secilit Shtet Kontraktues, do të konsiderohen si të ardhura të një banori të një Shteti Kontraktues por vetëm në nivelin që e ardhura është trajtuar për qëllime të tatimit nga ai Shtet, sikurse e ardhur e një banori të atij Shteti.

NENI 2

TATIMET E MBULUARA

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për tatimet në të ardhura të vëna në emër të një Shteti Kontraktues apo të nënndarjeve të tyre politike apo autoriteteve lokale, pavarësisht mënyrës se si arkëtohen ato.
2. Do të konsiderohen si tatime në të ardhura të gjitha tatimet e vëna në të ardhurat totale, apo në elementet e të ardhurave, duke përfshirë tatime në fitime nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme apo të paluajtshme, tatimet në shumat totale të pagave ose mëditjeve të paguara nga ndërmarrjet, sikurse edhe tatimet në vlerësimin e kapitalit:
3. Tatimet ekzistuese ndaj të cilave zbatohet Marrëveshja veçanërisht janë:
 - a) në rastin e Kosovës:
 - i) tatimi në të ardhura personale;
 - ii) tatimi në të ardhura të korporatave;
(në tekstin e mëtejshëm referuar si “tatimi Kosovar”);
 - b) në rastin e pjesës Evropiane të Holandës:
 - i) tatimi në të ardhura (de inkomstenbelasting);
 - ii) tatimi në paga (de loonbelasting);
 - iii) tatimi në kompani (de vennootschapsbelasting) përfshirë edhe aksionet e Qeverisë në fitimet neto nga shfrytëzimi i burimeve natyrore të arkëtuara sipas Aktit të Minierave (de Mijnbouwwet);
 - iv) tatimi në dividendë (de dividendbelasting); dhe
 - c) në rastin e pjesës Karaibeane të Holandës:
 - i) tatimi në të ardhura (de inkomstenbelasting);
 - ii) tatimi në paga (de loonbelasting);
 - iii) tatimi në pronë (de vastgoedbelasting);
 - iv) tatimi në të hyra (de opbrengstbelasting);
 - v) Aksionet e Qeverisë në fitimet neto nga shfrytëzimi i burimeve natyrore të arkëtuara sipas Aktit të Minierave BES (de Mijnwet BES), Dekreti për Miniera BES (het Mijnbesluit BES) ose Akti i Naftës Saba Bank BES (de Petroleumwet Saba Bank BES);

(në tekstin e mëtejshëm referuar si “tatimi Holandez”).
4. Marrëveshja po ashtu aplikohet për çdo tatim identik të ngjashëm apo thelbësor, të cilat vihen pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes, përveç, apo në vend të, tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese e njoftojnë njëra tjetrën për çdo ndryshim domethënës i cili është bërë në ligjet e tyre përkatëse tatimore.

KAPITULLI II PËRKUFIZIMET

NENI 3

PËRKUFIZIMET E PËRGJITHSHME

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, përveç nëse kërkohet ndryshe nga konteksti:
 - a) shprehja "Kosovë" nënkupton Republikën e Kosovës, përfshirë tërë territorin tokësor dhe hapësirën ajrore mbi të, mbi të cilën ka juridiksion apo të drejta sovrane për qëllime të eksplorimit, shfrytëzimit dhe ruajtjes së burimeve natyrore sipas ligjit ndërkombëtar;
 - b) shprehja "Holandë" nënkupton:
 - i. Pjesa Evropiane e Mbretërisë së Holandës, përfshirë edhe detin e saj territorial si dhe zonën përtej dhe të afërme me detin e saj territorial brenda së cilit Mbretëria e Holandës, në pajtim me ligjin ndërkombëtar, ushtron juridiksionin ose të drejtat sovrane; dhe
 - ii. Pjesa Karaibeane e Mbretërisë së Holandës e cila gjendet në Detin e Karaibeve dhe përbëhet nga territoret ishuj të Bonaire, Sint Eustatius dhe Saba, përfshirë edhe detin e saj territorial si dhe zonën përtej dhe të afërme me detin e saj territorial brenda së cilit Mbretëria e Holandës, në pajtim me ligjin ndërkombëtar, ushtron juridiksionin ose të drejtat sovrane, por duke përjashtuar pjesët prej saj në lidhje me Aruba, Curaçao dhe Sint Maarten;
 - c) shprehjet "një Shtet Kontraktues" dhe "Shteti tjetër Kontraktues" nënkuptojnë Mbretërinë e Holandës ose Kosovën siç e kërkon konteksti;
 - d) shprehja "person" përfshin një individ, një kompani dhe çdo organ tjetër të personave;
 - e) Shprehja "kompani" nënkupton, çdo organ korporatë apo çdo subjekt që trajtohet si organ korporatë për qëllime tatimore;
 - f) shprehja "ndërmarrje" zbatohet ndaj kryerjes së ndonjë veprimtarie biznesi;
 - g) shprehjet "ndërmarrja e Shtetit Kontraktues" dhe "ndërmarrja e Shtetit tjetër Kontraktues" nënkuptojnë përkatësisht një ndërmarrje e cila drejtohet nga një rezident i Shtetit Kontraktues dhe një ndërmarrje e drejtuar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;
 - h) shprehja "trafiku ndërkombëtar" nënkupton çdo transport me anije apo aeroplan përveç kur anija ose aeroplani operon vetëm ndërmjet vendeve në një Shtet Kontraktues dhe se ndërmarrja që operon me anijen apo aeroplanin nuk është një ndërmarrje e atij shteti;
 - i) shprehja "autoriteti kompetent" nënkupton:
 - (i) në rastin e Kosovës, Ministria e Financave apo përfaqësuesi i saj i autorizuar; dhe
 - (ii) në rastin e Holandës, Ministri i Financave ose përfaqësuesi i tij i autorizuar;
 - j) shprehja "shtetas", sa i përket Shtetit Kontraktues, nënkupton:

- i) në rastin e Holandës, çdo individ që ka shtetësinë e Mbretërisë së Holandës dhe çdo person juridik, partneritet ose shoqatë që ka statusin e vet të tillë sipas ligjeve në fuqi në Holandë;
- ii) në rastin e Kosovës, çdo individ që ka shtetësinë e Republikës së Kosovës dhe çdo person juridik, partneritet ose shoqatë që ka statusin e vet të tillë sipas ligjeve në fuqi në Kosovë;
- (k) shprehja “biznes” përfshin performancën e shërbimeve profesionale dhe të aktiviteteve tjera të një karakteri të pavarur;
- (l) shprehja “fondi i njohur pensional” i Shtetit, nënkupton një subjekt apo aranzhim të themeluar në atë Shtet që trajtohet si person i ndarë sipas ligjeve tatimore të atij Shteti, dhe:
 - i) që është themeluar dhe operon ekskluzivisht apo pothuajse ekskluzivisht për të administruar apo ofruar përfitime nga pensionimi dhe përfitime ndihmëse ose aksidentale për individët dhe që është e rregulluar ashtu nga ai Shtet, apo prej ndonjë prej nënndarjeve të tij politike ose autoritetet lokale; ose
 - ii) që është themeluar dhe operon ekskluzivisht apo pothuajse ekskluzivisht për të investuar fondet për përfitim të subjekteve apo aranzhimeve të referuara sipas nënndarjeve (i).

2. Sa i përket zbatimit të Marrëveshjes në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo shprehje jo e përcaktuar aty, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, apo autoritetet kompetente pajtohen për kuptim të ndryshëm sipas dispozitave të nenit 23, e ka kuptimin që e ka pasur në atë kohë sipas ligjit të atij Shteti për qëllime të tatimit ndaj të cilave zbatohet Marrëveshja, çdo kuptim sipas ligjeve të aplikueshme tatimore të atij Shteti që mbizotëron mbi një kuptim duke pasur parasysh shprehjen sipas ligjeve të tjera të atij Shteti.

NENI 4

REZIDENT

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, shprehja "rezident i Shtetit Kontraktues" nënkupton çdo person i cili, sipas ligjeve të atij Shteti, është përgjegjës ndaj tatimeve aty, për shkak të kriterit të vendbanimit, rezidencës, vendit të menaxhimit, vendit të përfshirjes, apo ndonjë kriteri tjetër me natyrë të ngjashme, gjithashtu përfshin edhe atë Shtet dhe çdo nënndarje administrative apo autoritet lokal me të, sikurse edhe fondin e njohur pensional të atij Shteti. Megjithatë, kjo shprehje nuk përfshin asnjë person i cili është përgjegjës ndaj tatimeve në atë Shtet lidhur vetëm me të ardhurat nga burimet në atë Shtet.
2. Kur sipas arsyeve të dispozitave të paragrafit 1, individi është rezident i të dyja Shteteve Kontraktuese, atëherë statusi i tij përcaktohet si në vijim:
 - a) ai konsiderohet se është rezident i vetëm atij Shteti, në të cilin ai ka një vendbanim të përhershëm në dispozicion për të; nëse ka vendbanim të përhershëm në dispozicion për të në të dyja Shtetet, ai konsiderohet se është rezident i vetëm atij Shteti me të cilin marrëdhëniet e tij personale dhe ekonomike janë më të afërta (qendra me interesa vitale);
 - b) Nëse nuk mund të përcaktohet Shteti në të cilin ai ka qendrën e tij të interesave vitale, apo nëse nuk ka vendbanim të përhershëm në dispozicion për të në asnjërin Shtet, ai konsiderohet se është rezident i vetëm atij Shteti në të cilin ai ka vendbanim të rregullt;
 - c) Nëse ka vendbanim të rregullt në të dyja Shtetet apo nëse nuk ka në asnjërin nga to, ai konsiderohet se është rezident i vetëm atij Shteti në të cilin është shtetas;
 - d) Nëse ai është shtetas i të dyja Shteteve apo nuk është i asnjërës nga to, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese e zgjidhin çështjen përmes një marrëveshjeje reciproke.
3. Kur sipas arsyeve të dispozitave të paragrafit 1, një person përveç individit, është një rezident i të dyja Shteteve Kontraktuese, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të përpiqen që të përcaktojnë me marrëveshje të përbashkët në Shtetin Kontraktues në të cilin personi do të konsiderohet që është një rezident për qëllimet e Marrëveshjes, duke pasur parasysh vendndodhjen e tij të menaxhimit efektiv, vendin ku është inkorporuar ose ndryshe themeluar dhe çdo faktor tjetër përkatës. Në mungesë të një Marrëveshjeje të tillë, një person i tillë nuk do të ketë të drejtë në asnjë lehtësim ose lirim nga tatimi i parashikuar nga kjo Marrëveshje përveç në nivelin dhe në atë mënyrë që mund të bihet dakord nga autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese.

NENI 5

NJËSIA E PËRHERSHME

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, shprehja “njësia përherëshme” nënkupton një vend fiks të punës përmes së cilës puna e një ndërmarrjeje zhvillohet plotësisht apo pjesërisht.
2. shprehja “njësia përherëshme” përfshin veçanërisht:
 - a) një vend të menaxhimit;
 - b) një degë;
 - c) një zyrë;
 - d) një fabrikë;
 - e) një punëtori, dhe
 - f) një minierë, një pus me naftë ose gaz, një gurorë apo ndonjë vend tjetër për nxjerrjen e burimeve natyrore.
3. shprehja “njësi e përherëshme” po ashtu përfshin:
 - a) Një punishte, një ndërtim, mbledhje apo projekt instalimi ose aktivitete mbikëqyrëse në lidhje me këtë, por vetëm nëse një punishte e tillë, projekt ose aktivitete zgjatin më shumë se 12 muaj;
 - b) ofrimi i shërbimeve, përfshirë shërbimet e konsulencës nga një ndërmarrje përmes punonjësve apo përmes personelit tjetër të angazhuar nga ndërmarrja për qëllim të tillë, por vetëm nëse aktivitetet e asaj natyre vazhdojnë në kuadër të Shtetit Kontraktues (për një projekt të njëjtë apo të ngjashëm) për një periudhë apo për periudha që grumbullojnë më shumë 9 muaj në çdo periudhë 12 mujore, që fillon apo përfundon në vitin fiskal në fjalë.
4. Pavarësisht dispozitave të paragrafëve 1, 2 dhe 3, një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues e cila i bart aktivitetet në detin territorial të Shtetit tjetër Kontraktues ose në ndonjë zonë tjetër përtej ose të afërme me detin e saj territorial brenda të cilit ai Shtet tjetër Kontraktues në pajtim me ligjin ndërkombëtar, ushtron juridiksion apo të drejta, sovrane, këtej e tutje referuar si **aktivitetet e jashtme (“offshore”)**, do të konsiderohet se drejton, në lidhje me ato aktivitete, biznes në atë Shtet tjetër përmes një njësie të përherëshme të vendosur atje, përveç nëse aktivitetet në fjalë drejtohen në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha më pak se 30 ditë të mbledhura në çdo periudhë 12-mujore.
5. Për qëllim të paragrafit 4, shprehja **aktivitetet e jashtme (“offshore”)** konsiderohet se nuk përfshin:
 - a) Një ose ndonjë kombinim të aktiviteteve të përmendura në paragrafin 7;
 - b) tërheqja ose trajtimi i ankorimit nga anijet të dizajnuara kryesisht për atë qëllim dhe çdo aktivitet tjetër i kryer nga anije të tilla;

- c) transporti i furnizimeve ose personelit nga një anije ose një aeroplan në komunikacionin ndërkombëtar.
6. Për qëllimin e vetëm të përcaktimi të kohëzgjatjes së:
- a) një punishte ose ndërtim, mbledhje ose një projekt instalimi sipas paragrafit 3, kur një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues drejton aktivitete në Shtetin tjetër Kontraktues në një vend që përbën një punishte ose ndërtim, mbledhje ose projekt instalimi dhe se këto aktivitete kryhen gjatë një ose më shumë periudhave kohore që, në total, tejkalojnë 30 ditë pa kaluar më shumë se 12 muaj, dhe aktivitetet e lidhura kryhen në të njëjtën punishte ose ndërtim, mbledhje ose projekt instalimi gjatë periudhave të ndryshme kohore, secila që tejkalon 30 ditë, nga një ose më shumë ndërmarrje të lidhura ngushtë me ndërmarrjen e përmendur së pari; këto periudha të ndryshme kohore do t'i shtohen periudhës kohore gjatë së cilës ndërmarrja e përmendur së pari ka kryer aktivitete në atë punishte ose ndërtim, mbledhje ose projekt instalimi; dhe
- b) **aktivitetet e jashtme (“offshore”)** sipas paragrafit 4, ku një ndërmarrje e Shtetit Kontraktues kryen apo drejton **aktivitetet e jashtme (“offshore”)** në Shtetin tjetër dhe aktivitetet e lidhura kryhen në atë Shtet nga një ose më shumë ndërmarrje të lidhura ngushtë me ndërmarrjen e përmendur së pari, periudhat e kohës gjatë të cilave aktivitetet e tilla të lidhura kryhen nga ato ndërmarrje do t'i shtohen periudhës kohore gjatë së cilës ndërmarrja e përmendur së pari ka kryer **aktivitetet e jashtme (“offshore”)** në atë Shtet tjetër Kontraktues.
7. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, shprehja “njësie përhershme” do të konsiderohet se nuk përfshin:
- a. përdorimin e objekteve vetëm për qëllimin e magazinimit, shfaqjes apo dërgimit të mallrave apo mallit që i përket ndërmarrjes;
- b. mirëmbajtjen e stoqeve të mallrave apo mallit që i përket ndërmarrjes vetëm për qëllime të magazinimit, shfaqjes apo dërgimit;
- c. mirëmbajtjen e stoqeve të mallrave apo mallit që i përket ndërmarrjes vetëm për qëllime të procedimit të tyre nga një ndërmarrje tjetër;
- d. mirëmbajtjen e një vendi fiks të biznesit vetëm për qëllime të blerjes së mallrave apo mallit apo të mbledhjes së informatave për ndërmarrjen;
- e. mirëmbajtjen e një vendi fiks të biznesit vetëm për qëllime të kryerjes, lidhur me ndërmarrjen, së çdo aktiviteti tjetër;
- f. mirëmbajtjen e një vendi fiks të punës vetëm për ndonjë kombinim të aktiviteteve të përmendura në nën paragrafët a) deri e),

me kusht që aktiviteti i tillë ose, në rastin e paragrafit f), i gjithë aktiviteti i vendit fiks ose biznesit, është i karakterit përgatitor ose ndihmës.

8. Paragrafi 7 nuk do të zbatohet për një vend fiks të biznesit që përdoret ose mirëmbahet nga një ndërmarrje nëse e njëjta ndërmarrje ose një ndërmarrje e lidhur ngushtë kryen veprimtari biznesi në të njëjtin vend ose në një vend tjetër në të njëjtin Shtet Kontraktues, dhe

- a) ai vend ose tjetër përbën një njësi të përhershme për ndërmarrjen ose ndërmarrjen e lidhur ngushtë sipas dispozitave të këtij neni, ose
- b) i tërë aktiviteti që buron nga kombinimi i aktiviteteve të kryera nga dy ndërmarrjet në të njëjtin vend, ose nga ndërmarrja e njëjtë apo ndërmarrjet e lidhura ngushtë në të dyja vendet, nuk është i karakterit përgatitor ose ndihmës,

me kusht që aktivitetet e biznesit të kryera nga dy ndërmarrjet në të njëjtin vend, ose nga ndërmarrjet e njëjta ose ndërmarrjet e lidhura ngushtë në të dyja vendet, përbëjnë funksione plotësuese që janë pjesë e një operacioni koheziv të biznesit.

9. Pavarësisht dispozitave të paragrafëve 1, 2 dhe 4 por subjekt i dispozitave të paragrafit 10, ku një person vepron në Shtetin Kontraktues në emër të një ndërmarrjeje dhe, duke vepruar ashtu, zakonisht lidh kontrata, ose zakonisht luan rolin kryesor që çon në lidhjen e kontratave që zakonisht lidhen pa ndryshime materiale nga ndërmarrja, dhe se këto kontrata janë;

- a) në emër të ndërmarrjes,
- b) për transferimin e pronësisë së, apo për dhënien e së drejtës për përdorim, pronë në pronësi të asaj ndërmarrjeje ose që ndërmarrja ka të drejtë të përdorë, ose
- c) për ofrimin e shërbimeve nga ajo ndërmarrje,

ajo ndërmarrje do të konsiderohet se ka një njësi të përhershme në atë Shtet sa i përket çdo aktiviteti që personi e ndërmerr për ndërmarrjen, përveç nëse aktivitetet e personit të tillë janë të kufizuara në ato të përmendura në paragrafin 7 që, nëse ushtrohen përmes një vendi fiks të biznesit përveç një vendi fiks të biznesit për të cilin do të zbatohet paragrafi 8, nuk do ta bënte këtë vend fiks të biznesit një njësi të përhershme sipas dispozitave të këtij paragrafi.

10. Paragrafi 9 nuk do të zbatohet ku personi i cili vepron në një Shtet Kontraktues në emër të një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues drejton biznes në Shtetin e përmendur së pari si një agjent i pavarur dhe vepron për ndërmarrjen në rrjedhën normale të atij biznesi. Ku, sidoqoftë, një person vepron ekskluzivisht apo pothuajse ekskluzivisht në emër të një apo më shumë ndërmarrjeve me të cilat është ngushtë i lidhur, ai person nuk konsiderohet që është një agjent i pavarur brenda kuptimit të këtij paragrafi sa i përket ndonjë ndërmarrjeje të tillë.

11. Për qëllim të këtij neni, një person ose një ndërmarrje është ngushtë e lidhur me një ndërmarrje nëse, sipas të gjitha fakteve relevante dhe rrethanave, njëra ka kontrollin mbi tjetrën ose të dyja janë nën kontroll të personave të njëjës ose ndërmarrjeve. Në çdo rast, një person ose një ndërmarrje do të konsiderohet si e lidhur ngushtë me një ndërmarrje nëse njëra posedon drejtpërdrejtë ose tërthorazi më shumë se 50 për qind të interesit përfitues në tjetrën (ose, në rastin e një kompanie, më shumë se 50 për qind e votës së përgjithshme dhe vlera e aksioneve të kompanisë ose e interesit të kapitalit përfitues në kompani) ose nëse një person ose ndërmarrje posedon drejtpërdrejtë ose tërthorazi më shumë se 50 për qind të interesit përfitues (ose, në rastin e një kompanie, më shumë se 50 për qind të votës së përgjithshme dhe vlerës së

aksioneve të kompanisë ose të interesit të kapitalit përfitues në kompani) në personin dhe ndërmarrjen ose në të dyja ndërmarrjet.

12. Fakti që një kompani që është rezidente e Shtetit Kontraktues, e kontrollon apo kontrollon nga kompania që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues, apo e cila e zhvillon biznesin në atë Shtetet tjetër (qoftë përmes një njësie apo ndryshe) vetë nuk do të përbëjë as kompani e as njësi të tjetrës.

KAPITULLI III TATIMI I TË ARDHURAVE

NENI 6

TË ARDHURAT NGA PRONA E PALUAJTSHME

1. Të ardhurat që burojnë nga një rezident i Shtetit Kontraktues nga prona e paluajtshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia apo pylltaria) e vendosur në një Shtet tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet tjetër.
2. Shprehja "pronë e paluajtshme" ka kuptimin, që e ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues në të cilin është e vendosur prona në fjalë. Shprehja në secilin rast përfshin pronën ndihmëse ndaj pronës së paluajtshme, bagëtinë dhe pajisjet që përdoren në bujqësi dhe pylltari, të drejta këto ndaj së cilave aplikohen dispozitat e ligjit të përgjithshëm që respektojnë pronën tokë, uzufukt i pronës së paluajtshme dhe të drejtat ndaj pagesave të ndryshme apo fikse si konsideratë për punën, apo të drejtën e punës, depozitat minerale, burimet dhe burimet tjera natyrore; anijet dhe avionët nuk konsiderohen si pronë e paluajtshme.
3. Dispozitat e paragrafit 1 aplikohen ndaj të ardhurave që burojnë nga përdorimi direkt, qiradhënia apo përdorimi në çdo formë i pronës së paluajtshme.
4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 gjithashtu aplikohen ndaj të ardhurave nga prona e paluajtshme e një ndërmarrjeje.

NENI 7

FITIMET NGA BIZNESI

1. Fitimet e ndërmarrjes së një Shteti Kontraktues janë të tatueshme vetëm në atë Shtet, përveç nëse ndërmarrja e drejton biznesin në një Shtet tjetër Kontraktues përmes një njësie të përhershme të vendosur aty. Nëse ndërmarrja e drejton biznesin si më lart, fitimet që atribuohen ndaj njësisë së përhershme në përputhje me dispozitat e paragrafit 2, mund të taten në atë Shtet tjetër.
2. Për qëllimet e këtij neni dhe nenit 21, fitimet që atribuohen në secilin Shtet kontraktues ndaj njësisë së përhershme, të cilat referohen në paragrafin 1, janë fitime që mund të pres t'i bëj, në veçanti në marrëveshjet e saja me pjesët tjera të ndërmarrjes, sikur të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe e pavarur, e angazhuar në aktivitetet e njëjta apo të ngjashme sipas kushtëve të njëjta apo të ngjashme, duke marrë parasysh funksionet e kryera, pasuritë e përdorura dhe rreziqet e marra nga ndërmarrja përmes njësisë së përhershme dhe përmes pjesëve tjera të ndërmarrjes.
3. Aty ku në përputhje me paragrafin 2, Shteti Kontraktues i korrigjon fitimet që atribuohen ndaj njësisë së përhershme të një ndërmarrjeje të njërit prej Shteteve Kontraktuese dhe i taton ato në përputhje me këto fitime të ndërmarrjes që janë ngarkuar me tatim në Shtetin tjetër, Shteti tjetër, deri në shkallën që është e nevojshme për të eliminuar tatimin e dyfishtë më këto fitime, e bën korrigjimin e përshtatshëm ndaj shumës së tatimit të ngarkuar në ato fitime.
4. Aty ku fitimet përfshijnë zërat e të ardhurave të cilat trajtohen ndarazi në nenet tjera të kësaj Marrëveshjeje, atëherë dispozitat e atyre neneve nuk preken nga dispozitat e këtij neni.

NENI 8

TRANSPORTI NDËRKOMBËTAR DHE TRANSPORTI AJROR

1. Përfitimet e një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues nga operimi me anije dhe aeroplanë në komunikacionin ndërkombëtar do të jenë të tatueshme vetëm në atë Shtet.
2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni aplikohen gjithashtu ndaj fitimeve nga pjesëmarrja në një ortakëri, biznes të përbashkët apo në një agjenci operuese ndërkombëtare.

NENI 9

NDËRMARRJET E NDËRLIDHURA

1. Ku

- a. një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë direkt apo indirekt në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, ose
- b. të njëjtit persona marrin pjesë direkt apo indirekt në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e një ndërmarrjeje të Shtetit Kontraktues dhe një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues,

dhe në secilin rast kushtet janë bërë ose vendosur në mes të dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare apo financiare të cilat dallojnë nga ato të cilat do të bëheshin në mes të ndërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim i cili, përveç atyre kushteve, do të mbledhej në njërin prej ndërmarrjeve, por për arsye të këtyre kushteve nuk janë mbledhur, mund të përfshihen në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe tatohen në përputhje me të. Është e kuptueshme, sidoqoftë, se fakti që ndërmarrjet e asociuara kanë lidhur aranzhime, sikurse aranzhimet për ndarjen e kostove ose marrëveshjet për shërbime të përgjithshme, për ose bazuar në shpërndarjen e alokimit e shpenzimeve ekzekutive, të përgjithshme administrative, teknike dhe tregtare, shpenzimet e hulumtimit dhe zhvillimit, dhe shpenzimet e tjera të ngjashme, nuk janë në vetvete një kusht siç përcaktohet në fjalinë e mëparshme.

2. Aty ku Shteti Kontraktues i përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të atij Shteti – dhe tatimeve në përputhje me këtë – fitimet mbi të cilat ndërmarrja e Shtetit tjetër Kontraktues është ngarkuar me tatim në atë Shtet tjetër dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitime, të cilat do t'i grumbulloheshin ndërmarrjes së Shtetit të parë të përmendur, nëse kushtet e vëna në mes të dy ndërmarrjeve, të kishin qenë ato të bëra në mes të ndërmarrjeve të pavarura, atëherë ky Shtet tjetër do t'i bëjë korrigjimet e përshtatshme në shumën e tatimit të ngarkuar aty ndaj atyre fitimeve. Në përcaktimin e këtij korrigjimi, do t'i kushtohet kujdesi i duhur dispozitave tjera të kësaj Marrëveshjeje, ndërsa autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, nëse është e nevojshme, e konsultojnë njëra tjetrën.

NENI 10

DIVIDENDAT

1. Dividendat e paguara nga kompania e cila është rezidente e Shtetit Kontraktues ndaj rezidentit të Shtetit tjetër kontraktues, mund të tatóhet në atë Shtetin tjetër.
2. Megjithatë, dividendat e paguara nga një kompani e cila është rezidente e një Shteti Kontraktues po ashtu mund të tatóhet në atë Shtet sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i dividendave është rezident i atij Shteti tjetër Kontraktues, tatimi i ngarkuar ashtu nuk të tejkalojë 15 për qind të shumës së përgjithshme të dividendave.
3. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 2, dividendat e referuara në paragrafin 1 do të jenë të tatueshme vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse pronari përfitues i dividendave është:
 - a) një kompani (përveç se një partneritet) e cila është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues dhe se mban drejtpërdrejtë së pakut 10 për qind të kapitalit të kompanisë e cila i paguan dividendat përgjatë periudhës prej 365 ditëve e cila përfshin ditën e pagesës së dividendës (me qëllim të llogaritjes së asaj periudhe, nuk merret në konsideratë asnjë ndryshim i pronësisë që mund të rezultojnë drejtpërdrejt nga një riorganizim i korporatës, siç është bashkimi ose riorganizimi ndarës, i kompanisë që mban kapitalin ose që paguan dividendën); ose..
 - b) një fond pensional i njohur i cili përgjithësisht është i liruar nga tatimi i kompanisë ose tatimi mbi të ardhurat e korporatave, përkatësisht.
4. Dispozitat e paragrafëve 2 dhe 3 nuk do të ndikojnë:
 - a) Tatimet e kompanisë sa i përket fitimit nga i cili paguhen dividendat,
 - b) E drejta e Holandës që të caktojë tatim në të hyra në pajtim me ligjet e saj.
5. Shprehja “dividendat” siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga aksionet, “jouissance” aksionet ose të drejtat “jouissance”, aksionet e minierave, aksionet e themeluesve apo të ardhurat tjera, duke mos qenë kërkesa-borxhi që marrin pjesë në fitime, sikurse edhe të ardhurat nga të të drejtat tjera të korporatave që janë subjekt i trajtimit të njëjtë të tatimeve sikurse të ardhurat nga aksionet sipas ligjeve të Shtetit në të cilën kompania që bën shpërndarjen është rezidente.
6. Dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 3 nuk aplikohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i Shtetit Kontraktues, e drejton biznesin në Shtetin tjetër kontraktues në të cilin kompania e cila i paguan Dividendat është rezident, përmes një njësie të përhershme e cila është e vendosur aty, dhe mbajtja e të cilave sa i përket dividendave paguhen. mënyrë efektive është e lidhur me njësinë e tillë të përhershme. Në rastin e tillë, aplikohen depozitat e nenit 7.
7. Aty ku një kompani e cila është rezidente e Shtetit Kontraktues nxjerr fitime apo të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ai Shteti tjetër nuk mund të caktojë ndonjë tatim në dividendë të paguar nga kompania, përveç deri në shkallën që Dividendat e tilla i paguhen rezidentit të atij Shteti tjetër, apo përderisa mbajtja për të cilat Dividendat e tilla paguhen, është e lidhur në mënyrë efektive me njësinë të vendosur në atë Shtetin

tjetër, as nuk i ekspozon fitimet e paspërndara të kompanisë ndaj tatimeve në fitimet e paspërndara të kompanisë, madje edhe nëse Dividendat e paguara apo fitimet e paspërndara përbëhen plotësisht apo pjesërisht nga fitimet apo të ardhurat që burojnë në Shtetin tjetër të tillë.

NENI 11

INTERESI

1. Interesi që buron në një Shtet Kontraktues dhe që i paguhet rezidentit të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatóhet në atë Shtet tjetër.
2. Sidoqoftë, interesi që buron në një Shtet Kontraktues po ashtu mund të tatóhet në atë Shtet sipas ligjeve të atij Shteti, por nëse pronari përfitues i interesit është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, tatimi i ngarkuar në mënyrën e tillë, nuk tejkalon 10 për qind të shumës bruto të interesit.
3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, interesat që burojnë në një Shtet Kontraktues dhe i paguhet një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, i cili është pronari përfitues i tyre, do të tatóhen vetëm në atë Shtetin tjetër deri në masën që interesi i tillë paguhet:
 - a) për sa i përket borxhit që buron si pasojë e shitjes me kredi të çdo pajisje, malli ose shërbimi;
 - b) ndaj një fondi të njohur pensional, i cili përgjithësisht është i liruar nga tatimi i kompanisë ose tatimi mbi të ardhurat e korporatave, përkatësisht, ose
 - c) Qeverisë së atij Shteti tjetër, një nënndarjeje politike apo autoriteti lokal të saj, apo Bankës Qendrore të atij Shteti tjetër.
4. Shprehja "interes" siç është përdorur në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga kërkesat e borxhit të çdo lloji, qoftë apo jo i siguruar nga hipoteka dhe pavarësisht apo jo mban një të drejtë të pjesëmarrjes në fitimet e debitorit, dhe në veçanti, të ardhurat nga letrat me vlerë të qeverisë dhe të ardhurat nga obligacionet apo obligacionet e shoqërisë aksionare, përfshirë premitë dhe çmimet duke ia bashkëngjitur letrave të tillë me vlerë, obligacioneve apo obligacionet e shoqërisë aksionare. Ngarkesat e ndëshkimeve për pagesat e vonuara nuk konsiderohen si interes për qëllime të këtij neni.
5. Dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 3 shall nuk aplikohen nëse pronari përfitues i interesit, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, drejton një biznes në Shtetin tjetër Kontraktues, në të cilin buron interesi përmes njësisë së vendosur aty, dhe kërkesa e borxhit lidhur me të cilën paguhet interesi, është e lidhur në mënyrë efektive me njësinë e tillë apo me bazën fikse. Në rastin e tillë, aplikohen dispozitat e nenit 7.
6. Interesi konsiderohet se buron në Shtetin Kontraktues kur paguesi është rezident i atij Shteti. Megjithatë, kur personi që paguan interesin, qoftë ai rezident apo jo rezident i Shtetit Kontraktues, ka në Shtetin Kontraktues një njësi të përhershme në lidhje me të cilën borxhi për të cilin paguhet interesi është shkaktuar, dhe interesi i tillë bartet nga njësia e tillë e përhershme, atëherë interesi i tillë konsiderohet se buron në Shtetin në të cilin gjendet njësia e përhershme.
7. Aty ku, për shkak të një marrëdhënieje të veçantë në mes të paguesit dhe pronarit përfitues apo në mes të të dyve dhe ndonjë personi tjetër, shuma e interesit, duke konsideruar kërkesën e borxhit për të cilën paguhet, e tejkalon shumën e cila do të ishte dakorduar nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të një marrëdhënieje të tillë, dispozitat e këtij neni aplikohen vetëm për shumën e fundit të përmendur. Në rastin e tillë, pjesa e tepërt e pagesave mbetet e

tatueshme në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke i kushtuar kujdesin e duhur dispozitave tjera të kësaj Marrëveshjeje.

NENI 12

TË DREJTAT PRONËSORE

1. Të drejtat pronësore që burojnë në një Shtet Kontraktues dhe janë përfitim në pronësi të një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, janë të tatueshme vetëm në atë Shtet tjetër.
2. Shprehja "të drejtat pronësore" siç përdoret në këtë nen nënkupton pagesat e çdo lloji të pranuar si konsideratë për shfrytëzimin, apo të drejtën për të përdorur, çfarëdo të drejtash të autorit për punën letrare, artistike apo shkencore përfshirë filmat kinematografik, çdo patentë, markë, dizajn apo model, plan, formulë sekrete apo proces, apo për informim lidhur me përvojën industriale, tregtare apo shkencore.
3. Dispozitat e paragrafit 1 nuk aplikohen nëse pronari përfitues i të drejtave pronësore, duke qenë rezident i Shtetit Kontraktues, e drejton biznesin në një Shtet tjetër Kontraktues në të cilin burojnë të drejtat pronësore përmes njësisë së përhershme vendosur aty, dhe e drejta apo prona sa i përket asaj për të cilën paguhen të drejtat pronësore, është e lidhur në mënyrë efektive me njësinë e tillë. Në rastin e tillë, aplikohen dispozitat e nenit 7.
4. Aty ku, për shkak të marrëdhënieve të veçanta në mes të paguesit dhe pronarit përfitues apo në mes të tyre dhe ndonjë personi tjetër, shuma e të drejtave pronësore, duke i kushtuar rëndësinë përdorimit të drejtës apo informatave për të cilat ato paguhen, tejkalojnë shumën e cila do të ishte pajtuar nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të marrëdhënies së tillë, dispozitat e këtij neni aplikohen vetëm ndaj shumës së fundit të përmendur. Në rastin e tillë, pjesa e tepërt e pagesave mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke i dhënë kujdesin e duhur dispozitave tjera të kësaj Marrëveshjeje.

NENI 13

FITIMET KAPITALE

1. Fitimet që burojnë nga rezidenti i Shtetit Kontraktues nga tjetërsimi i pronës e paluajtshme, referuar në nenin 6 dhe e vendosur në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet.
2. Fitimet nga tjetërsimi i ndonjë prone, përveç pronës së paluajtshme siç përkufizohet në nenin 6, që përbën një pjesë të pronës së biznesit të një njësie të përhershme të cilën një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues e ka në Shtetin tjetër Kontraktues, përfshirë fitimet e tilla nga tjetërsimi njësisë së tillë të përhershme (vetëm apo me tërë ndërmarrjen), mund të tatohen në atë Shtet tjetër.
3. Fitimet nga tjetërsimi i anijeve ose aeroplanëve që operojnë në komunikacionin ndërkombëtar ose ndonjë prone, përveç pronës së paluajtshme siç përkufizohet në nenin 6, që kanë të bëjnë me operimin e anijeve ose aeroplanëve të tillë, do të jenë të tatueshme vetëm në atë Shtet.
4. Fitimet nga tjetërsimi i çdo prone, përveç asaj të referuar në paragrafët 1, 2 dhe 3, janë të tatueshme vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin tjetërsuesi është rezident.
5. Kur një individ ishte rezident i një Shteti Kontraktues dhe është bërë rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, dispozitat e paragrafit 4 nuk do të pengojnë që Shteti i parë i përmendur të tatojë sipas ligjit të tij të brendshëm vlerësimin kapital të aksioneve, certifikatat e ndarjes së fitimit, opsionet e thirrjeve dhe uzufukti i aksioneve dhe certifikatave të ndarjes së fitimit, dhe kërkesat për borxh ndaj një kompanie për periudhën e qëndrimit të këtij individi në Shtetin e përmendur së pari. Në këtë rast, vlerësimi i kapitalit të tatuar në Shtetin e përmendur së pari nuk do të përfshihet në bazën tatimore kur përcaktohet vlerësimi i kapitalit nga Shteti tjetër.

NENI 14

TË ARDHURAT NGA PUNËSIMI

1. Duke iu nënshtruar dispozitave të neneve 15, 17 dhe 18, pagat, mëditjet dhe shpërblimet tjera të ngjashme që burojnë nga rezidenti i Shtetit Kontraktues lidhur me një punësim, janë të tatueshme vetëm në atë Shtet, përveç nëse punësimi ushtrohet në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse punësimi ushtrohet në këtë mënyrë, shpërblimi i tillë siç buron nga kjo, mund të tatóhet në Shtetin tjetër.
2. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1, shpërblimi që buron nga një rezident i Shtetit Kontraktues lidhur me punësimin e ushtroar në Shtetin tjetër Kontraktues, është i tatueshëm vetëm në Shtetin e parë të përmendur, nëse:
 - a) pranuesi është prezent në Shtetin tjetër për një periudhë apo për periudha që nuk tejkalojnë në total 183 ditë në secilën periudhë 12 mujore që fillon apo që përfundon në vitin fiskal në fjalë, dhe
 - b) shpërblimi paguhet nga, apo në emër të një punëdhënësi i cili nuk është rezident i Shtetit tjetër, dhe
 - c) shpërblimi nuk bartet nga njësia të cilën punëdhënësi e ka në Shtetin tjetër.
3. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, shpërblimet që burojnë nga një rezident i një Shteti Kontraktues sa i përket një punësimi si anëtar i plotësimit të rregullt të një anijeje ose aeroplani që operon në komunikacionin ndërkombëtar përveç se në bordin e një anijeje ose aeroplani që operon vetëm brenda Shtetit tjetër Kontraktues, do të jenë të tatueshme vetëm në Shtetin e përmendur së pari.

NENI 15

SHPËRBLIMET E DREJTORËVE

1. Shpërblimet e drejtorëve dhe pagesat tjera të ngjashme që burojnë nga rezidenti i një Shteti Kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i Bordit të Drejtorëve të Kompanisë e cila është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohet në Shtetin tjetër.
2. Për qëllime të dispozitave të paragrafit 1, shprehja "anëtar i bordit të drejtorëve" përfshin çdo person i cili është i ngarkuar me menaxhim të përgjithshëm të kompanisë dhe çdo person i cili është i ngarkuar me mbikëqyrje aty.

NENI 16

ARTISTËT DHE SPORTISTËT

1. Pavarësisht dispozitave të nenit 14 të ardhurat që burojnë nga rezidenti i një Shteti Kontraktues si argëtues, siç është aktori në teatër, film, radio apo televizion, artisti apo muzikanti, apo sportisti, nga aktivitetet personale të atij rezidenti të cilat si të tilla ushtrohen në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të taten në atë Shtet tjetër
2. Kur të ardhurat, sa i përket aktiviteteve personale të ushtruara nga një argëtues apo sportist në cilësinë e tij, si të tilla nuk i mblidhen vetë argëtuesit apo sportistit, por i mblidhen një personi tjetër, ajo e ardhur mundet, pavarësisht dispozitave të nenit 14 të taten në Shtetin Kontraktues, në të cilin ushtrohen aktivitetet e artistëve apo sportistëve.
3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen për të ardhurat që burojnë nga aktivitetet e kryera në një Shtet Kontraktues nga argëtuesit ose sportistët, nëse vizita në atë Shtet mbështetet tërësisht ose kryesisht nga fondet publike të një ose të dyja Shteteve Kontraktuese ose nënndarjeve politike ose autoritetet lokale të tyre. Në rast të tillë, të ardhurat që burojnë nga aktivitete të tilla do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin argëtuesi ose sportistët janë rezidentë.

NENI 17

PENSIONET, ANUITETET DHE PAGESAT E SIGURIMIT SOCIAL

1. Në varësi të dispozitave të paragrafit 2 të nenit 18, pensionet dhe kompensimet e tjera të ngjashme, si dhe anuitetet, që burojnë në një Shtet Kontraktues dhe i paguhet një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohen në shtetin e parë të përmendur.
2. Pensionet e paguara dhe pagesat e tjera të bëra sipas dispozitave të legjislationit të sigurimeve sociale të një Shteti Kontraktues ndaj një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në shtetin e parë të përmendur.
